Asgjësohen rreth 5 mijë rrënjë kanabis në një parcelë me misër në Vlorë, 3 në pranga

12 Tetor, 2023 09:13

Madhësia e tekstit:

Asgjësohen me anë të djegies 4930 bimë narkotike që ishin kultivuar në një parcelë me misër, në fshatin Bishan të Vlorës. Zbulohet në afërsi të parcelës, një magazinë e përshtatur për tharjen e bimëve narkotike, ndërsa në pranga ranë 3 autorët e dyshuar, shtetasit Skënder Llanaj, Danielo Llanaj dhe Bujar Hoxhaj.

Sakaq, janë proceduar penalisht kryeplaku i fshatit Bishan dhe 3 punonjës policie të Komisariatit të Policisë Vlorë.

NJOFTIMI I POLICISE

Sekuestrohen 198 kilogramë kanabis në proces tharjeje, 2 armë zjarri kallashnikov, 1 armë gjahu dhe një sasi fishekësh luftarak, që u gjetën gjatë kontrollit të magazinës. Kapen dhe vihen në pranga 3 autorët e dyshuar, të cilët dyshohet se kultivonin bimët narkotike dhe përgatitnin lëndën narkotike kanabis, për shitje.

Ndiqen penalisht kryeplaku i fshatit Bishan dhe 3 punonjës policie, pasi dyshohet se shpërdoruan detyrën duke mos përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë për kontrollin e zonës.

Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, në bazë të informacioneve të siguruara nga inteligjenca policore, për një rast të kultivimit të bimëve narkotike, kanë organizuar dhe finalizuar, në bashkëpunim me strukturat e DVP Fier, operacionin policor të koduar "Amid".

Gjatë operacionit, në fshatin Bishan, shërbimet e Policisë kanë

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Bilance të frikshme humbjesh, ministria e Shëndetësisë palestineze: 1354 të vdekur në Gaza
12 Tetor, 2023

"Jam sëmurë me covid", Laert Haxhiu refuzon të marrë dijeni mbi seancën, avokati pretendon....shtyhet gjyqi për autorin e masakrës së Lushnjes
12 Tetor, 2023

OKB dënon fuqishëm sulmet ndaj civilëve në Izrael dhe Gaza
12 Tetor, 2023

Emrat/ Goditen dy raste të trafikimit të klandestinëve, nëntë të arrestuar në Durrës
12 Tetor, 2023

"Mbështetja e Kosovës tregohet me vepra jo me fjalime të gjata", Tabaku sulmon kryeministrin: Këtu bëhet garë kush pëlqehet më shumë Rama apo Kurti
12 Tetor, 2023

Balla-opozitës: Përdorni Kosovën si instrument për të sulmuar Ramën! A thua se u djeg barku juve për vatanin
12 Tetor, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

konstatuar të kultivuara mes një parcele me misër, në pronësi të shtetasit D. M., 4930 bimë të dyshuara narkotike cannabis sativa, të cilat u asgjësuan me anë të djegies.

Nga kontrolli i territorit, në afërsi të kësaj parcele është zbuluar një magazinë e përshtatur për tharjen e bimëve narkotike dhe përgatitjen e lëndës narkotike, në pronësi të shtetasit S. Ll.

Në këtë magazinë janë gjetur 198 kg lëndë narkotike në proces tharjeje, 2 armë zjarri kallashnikov, 1 armë gjahu dhe një sasi fishekësh luftarak, të cilat janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale.

Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, specialistët për Hetimin e Narkotikëve të DVP Vlorë arrestuan në flagrancë shtetasit:

– S. Ll., 40 vjeç dhe D. Ll., 18 vjeç (babë e bir), banues në fshatin Bishan.

– D. M., 69 vjeç, banues në fshatin Bishan.

Po nga këto struktura u referuan materialet në Prokurori, për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", për shtetasit:

-B. H., 61 vjeç, me detyrë kryetar i fshatit Bishan.

Si dhe për 3 punonjës policie, të cilët edhe janë pezulluar nga detyra, konkretisht:

– Nënkomisar K. P., me detyrë shef i Seksionit për Krimet në Komisariatin e Policisë Vlorë;

– Nënkomisar F. M., me detyrë specialist për Hetimin e Krimeve, në Komisariatin e Policisë Vlorë;

– Inspektor M. A., me detyrë ndihmësspecialist (SPZ) në Komisariatin e Policisë Vlorë.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, për veprime të mëtejshme. Policia e Shtetit siguron edhe një herë qytetarët se është e vendosur për të luftuar krimin, në çdo fushë, gjë që po e tregon me rezultatet e këtij operacioni, sidomos me vendosmërinë për të larguar nga radhët e saj, çdo punonjës policie që kryen veprime në shkelje të detyrës. Në këtë kuadër, fton çdo qytetar që të mos hezitojë të informojë për rastet kur punonjësit e Policisë abuzojnë me detyrën.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: kanabis Vlore

TË NGJASHME

Dhunoi bashkëjetuesen dhe tentoi të largohej nga vendi, arrestohet 22-vjeçari anglez në Rinas
12 Tetor, 2023

Kapet duke shitur doza kanabisi, arrestohet i riu në Divjakë, procedohet edhe blerësi
12 Tetor, 2023

Taboola Feed

Kjo është mosha kur gratë tradhtojnë më shumë, studimi tregon 'pikun' e pabesisë

Kjo është mosha kur gratë tradhtojnë më shumë, studimi tregon 'pikun' e pabesisë

balkanweb.com

If you own a mouse, you have to play this game. No Install. Play for free.

PanzerRush | Sponsored

Lushnje: Click Here To See The Price Of Solar Panels

Solar Panels | Search Ads | Sponsored

Lushnje: Smart Beds Clearance Sale: Prices In Mexico Might Surprise You

Smart Beds In Mexico | Search Ads | Sponsored

Here's The New Kitchen Cabinet Trends Coming In 2023. (May Surprise)

Kitchen Cabinets | search ads | Sponsored



Top 30 Most Beautiful Women in the World

healthnfits.com | Sponsored

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

"Jam sëmurë me covid", Laert Haxhiu refuzon të marrë dijeni mbi seancën, avokati pretendon....shtyhet gjyqi për autorin e masakrës së Lushnjes

12 Tetor, 2023

Emrat/ Goditen dy raste të trafikimit të klandestinëve, nëntë të arrestuar në Durrës

12 Tetor, 2023

Nga flakadanët te kapsollat, policia ndalon sende të paligjshme para sfidës Shqipëri-Çeki, Balla: Aktet e dhunës në stadiume të marrin fund!

12 Tetor, 2023

Vodhi para, bizhuteri e sende me vlerë në një banesë, pranga 'skifterit' në Tiranë

12 Tetor, 2023

Video/ Aksident në Lezhë, automjeti përplas biçikletën, plagoset një i moshuar

12 Tetor, 2023

Gjirokastër/ 51-vjeçari gjerman dërgohet pa shenja jete në spital, ja çfarë dyshon policia

12 Tetor, 2023

KATEGORIA VIDEO



Emrat/ Goditen dy raste të trafikimit të klandestinëve, nëntë të arrestuar në Durrës

12 Tetor, 2023

Balla-opozitës: Përdorni Kosovën si instrument për të sulmuar Ramën! A thua se u djeg barku juve për vatanin

12 Tetor, 2023

UEFA "tremb" Çekinë, i kujton perlën e Jasir Asanit (VIDEO)

12 Tetor, 2023

"Sazexhinjtë e non gratës", Rama 90 minuta fjalim në Kuvend, injoron opozitën dhe shigjeton Kurtin: Shton votat duke ekspozuar mendjelehtësinë e SHBA dhe dritëshkurtësinë e Europës

12 Tetor, 2023

"Rama ka firmosur diku për ndarjen e Kosovës sipas oreksit të Serbisë", Berisha: Fati i tij është i lidhur jetë a vdekje me Vuçiçin, qëllim i tij është ndarja e Kosovës për oreks të Serbisë

12 Tetor, 2023

"Fjalimi i shkruar në zyrat e Vuçiçit", Berisha 'zbulon' prapaskenat e deklaratave të Ramës: Portretizoi si 'djall me zile' Kurtin

12 Tetor, 2023

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.